

502



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TROPOJË  
DREJTORIA E PYJEVE , KULLOTAVE DHE BUJQËSISË  
SEKTORI I PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr 260/9 prot.

B.Curri, më 22/2 /2022

Lënda: Dërgohet projekt-vendim dhe relacion

**KËSHILLIT BASHKIAK , TROPOJË**

**Të nderuar këshilltarë,**

Bashkangjitur ju dërgojmë për kompetencë shqyrtimi projekt-vendimin dhe relacionin:

**Dhënie pëlqimi për dhënie me qera të sipërfaqes prej 0.47 ha nga fondi pyjor-kullosor bashkiak me kategori përdorimi pyll (shkurre), ndodhur në ekonominë pyjore Lugina e Kolgecaje, me shtrirje nga fshati Koçanaj Njesia Administrative Margegaj deri ne fshatin Breg Lumi Njesia Administrative Fierze, ngastra 14a, në vendin e quajtur Gurorja ( gurore egzistuese e perdorur si e tille), bashkia Tropojë, për të vendosur një impiant të lëvizshëm për prodhimin dhe grumbullimin e materialeve te ndryshme ndërtimore ( rërë, zhavorr, beton, asfalt) nga subjekti "BYBERI" shpk regjistruar në Regjistrin themeltar që nga data 15.05.2013 me NIPT: L39115601Q, me përfaqësues ligjor z.Avni Byberi.**

**Duke ju uruar punë të mbarë.**

**Me respekt,**

Konceptoi: E.Mahmutaj  
Pranoi: K.Baliaj

**ME POROSI DHE I AUTORIZUAR**

**N/KRYETARI**

**Abedin KËRRNAJA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TROPOJË

Nr. 200/14 prot.

B.Curri, më 22/2 /2022

PROJEKT-VENDIM

NR. \_\_\_\_, Datë \_\_\_\_, \_\_\_\_, 2022

**“DHËNIE PËLQIMI NË PARIM PËR DHËNIEN ME QERA TË SIPËRFAQES PREJ 0.47 HA NGA FONDI PYJOR BASHKIAK ME KATEGORI PËRDORIMI pyll (shkurre), NDODHUR NË EKONOMINË PYJORE “LUGINA E KOLGECAJE” Ngastra 14a, NË VENDIN E QUAJTUR “GURORJA”, BASHKIA TROPOJË, PËR PRODHIMIN DHE GRUMBULLIMIN E MATERIALEVE TË NDRYSHME NDËRTIMORE(RËRË,ZHAVORR,BETON,ASFALT) DUKE VENDOSUR NJË IMPIANT TË LËVIZSHËM”**

Këshilli Bashkiak Tropojë në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_, \_\_\_\_. 2022 me propozim të Kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1,2, nenin 27.5, nenin 54 shkronja “e/1” të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Ligjin nr.8480 datë 27.5.1999 “ Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Ligjin nr.107/2014 datë 31.7.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, në Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”, në VKM nr. 134, datë 3.3.2021 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 433, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave të ish-komunave/ bashkive”, në VKM nr.591 datë 9.10.2018 “Për disa ndryshime në V.K.M-ve nr. 1353, datë 10.10.2008, “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, në VKM nr.592 datë 9.10.2018 “Për disa ndryshime në VKM nr.1374 datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullësor”, dhe në Udhëzimin nr.1 datë 09.06.2016 “Për rregullat procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik”, dhe relacionit të Drejtorisë së Pyjeve, Kullotave dhe Bujqësisë së bashkisë Tropojë:

**VENDOSI**

1. Dhënie pëlqimi në parim për dhënie me qera të sipërfaqes prej 0.47 ha nga fondi pyjor-kullësor bashkiak me kategori përdorimi pyll (shkurre) ndodhur në ekonominë pyjore “Lugina e Kolgecaje” ngastra 14a, në vendin e quajtur “Gurorja” (gurore egzistuese), bashkia Tropojë, për prodhimin dhe grumbullimin e materialeve të ndryshme ndërtimore (rërë,zhavorr,beton, asfalt) duke vendosur një impiant të lëvizshëm”
2. Dhënia me qera do të realizohet në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për administrimin e fondit pyjor-kullësor.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit.....

Konceptoi: E.Mahmutaj

Pranoi: K.Baliaj

Ligjshëmëria L.Vukçaj

ME POROSI DHE I AUTORIZUAR

N/KRYETARI  
Abedin KËRRNAJA







**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA TROPOJË**  
**DREJTORIA E PYJEVE, KULLOTAVE DHE BUJQËSISË**  
**SEKTORI I PYJEVE DHE KULLOTAVE**

Nr. 260/13 prot.

B.Curri, më 22.2.2022

**RELACION**

**Dhënie pëlqimi në parim për dhënien me qera të sipërfaqes prej 0.47 ha nga fondi pyjor bashkiak me kategori përdorimi pyll ndodhur në ekonominë kullosore “Lugina e Kolgecaje” ngastra 14a, në vendin e quajtur “Gurorja”, bashkia Tropojë, për prodhimin dhe grumbullimin e materialeve të ndryshme ndërtimore (rërë,zhavorr,beton,asfalt) duke vendosur një impiant të lëvizshëm”**

Bashkia Tropojë në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, ndër të cilat ka edhe administrimin e pyjeve dhe kullotave bashkiake, kjo sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, në lidhje me sipërfaqet e pyjeve dhe kullotave të kaluara nën administrimin e saj gjithsej 59173.66 ha .

Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet” neni 25 pika ç, në VKM nr. 134, datë 3.3.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive”, Udhëzimin nr.1 datë 09.06.2016 “Për rregullat procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik” propozojmë dhënien në përdorim të një sipërfaqe prej 4700 m<sup>2</sup> .

Referuar Udhëzimit nr.1 datë 09.06.2016 “Për rregullat procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”, Drejtoria e Pyjeve, Kullotave dhe Bujqësisë bazuar në pikën 7,22,24 të Udhëzimit të mësipërm i është drejtuar Kryetarit të Bashkisë për të dhënë në përdorim sipërfaqen e kërkuar .

Kërkuesi Avni Byberi i është drejtuar Bashkisë Tropojë me një “ Kërkesë për marrje në përdorim të një sipërfaqe prej 4700 m<sup>2</sup> fond pyjor” me nr. 260 prot, datë 14.01.2022, me objekt: prodhimin dhe grumbullimin e materialeve të ndryshme ndërtimore (rërë,zhavorr,beton,asfalt) duke vendosur një impiant të lëvizshëm, Bashkia Tropojë ka vlerësuar kërkesën bazuar në nenin 25 pika ç te Ligjit 57/2020 “Për pyjet” ka njoftuar kërkuesin me shkresën nr.260/1 Prot. B.Curri, më 14.01.2022 për dokumentacionin që duhet të paraqesë për plotësimin e kërkesës së tij. Subjekti ka paraqitur plan vendosjen në hartën pyjore projektin tekniko teknologjik të aktivitetit dhe kërkon miratimin në KB të sipërfaqes që

do jetë objekt kontrate pas miratimit të Lejes Mjedisore dhe hartimit të studimit që përfshin sipërfaqen e fondit pyjor prej 0.47 ha që ndodhen në ngastrën 14a të ekonomisë pyjore “Lugina e Kolgecaje” ( me shtrirje nga fshati Kocanaj, Njësia Administrative Margegaj deri ne fshatin Breg Lumi, Njësia Administrative Fierzë).

Ngastra 14a e ekonomisë pyjore Lugina Kolgecaje është pjesë territoriale e fshatit Geghysen Njësia Administrative Bujan . Kjo ngastër është shfrytëzuar për disa vite si gurore gjatë ndërtimit të HEC-it Fierzës dhe gjate viteve në vazhdim është shfrytëzuar për prodhim guresh dhe inertesh .

Distanca e objektit të ndërtimit nga shkolla “Matosh Uka” Fierze është 1.62 km vijë ajrore, sa i përket stacionit të pompave që ndodhet në afërsi sqarojme se :

Stacioni i pompave ndodhet sipër objektit që parshikohet të ndërtohet në gurore në një distance prej 435 m (bashkelidhur foto matjeve nepermjet programit ASIG).

Bashkia Tropojë me miratimin e Këshillit Bashkiak jep në përdorim (qera) prona për të tretët ndërsa, përshtatshmëria dhe ndikimi në mjedis që mund të ketë për shkak të zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme në zonën e dhënë në përdorim (qera) bëhet nga AKM ( Agjensia Kombëtare e Mjedisit).

Ky miratim kërkohet për arsye se Subjekti në fjalë nuk mund të lidhe kontratë me bashkinë pa patur lejen mjedisore, referuar Udhëzimit nr.1 datë 09.06.2016 “Për rregullat procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, pika 23 dhe 24 ku shprehimisht thuhet:

23. Në të gjitha rastet sipas pikës 22, subjekti i interesuar paraqet dokumentacionin teknik-ligjor pranë bashkisë, e cila i delegon të drejtën për hartimin e studimit teknik-ekonomik të sipërfaqes objekt përdorimi, strukturës përgjegjëse për pyjet në bashki.

24. Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria që zotëron lejen/licencën përkatëse përbëhet nga:

- a) leja/licenca përkatëse nga institucioni qendror për ushtrimin e veprimtarisë;
- b) kontrata/marrëveshja e lidhur me autoritetin përkatës për ushtrimin e aktivitetit sipas pikës 22 të këtij udhëzimi;
- c) projektin teknik dhe grafikun e punimeve të parashikuara;
- d) hartën topografike me koordinatat e sipër-faqes objekt përdorimi në formatin PDF dhe në format elektronik në shkallën 1:10000 ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: zona kadastrale sipas ZRPP-së, kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, si dhe lidhjen me të dhënat për treguesit kadastralë pyjorë dhe kullorë;
- e) lejen e mjedisit/deklarata e ministrit të Mjedisit;
- f) lejen e ndërtimit;
- g) aktin e regjistrimit pranë QKR-së.

Për sa më sipër në zbatim të nenit 54 shkronja “e/1” të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar rezulton se kjo eshte kopetencë e Këshillit Bashkiak, prandaj kërkohet

dhënien e pëlqimit në parim për dhënien me qera të sipërfaqes së kërkuar nga subjekti i sipërcituar për një periudhë kohore prej 9 (nëntë) vitesh.

Konceptoi: E.Mahmutaj



**DREJTORI**

**Kujtim Baliaj**





